



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORÇË

VENDIM

Nr 16 Datë 09.03.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E PRIORITETEVE TË INVESTIMEVE
PËR VITIN 2011**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi morri në analizë relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban e Hartimit të Projekteve në Infrastrukturë dhe Drejtoria e Financës, "Për përcaktimin e prioriteteve të investimeve për vitin 2011", mbështetur në: Ligji nr. 8652 dt.31.07.2000 " Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes vendore "neni 32 pika dh ,ligji 10355 dt. 02.12.2010 " Për buxhetin e vitit 2011",Udhëzimin Nr.4 datë 27.01.2011 " Për zbatimin e Buxhetit për Vitin 2011", ligji nr. 9936 dt.26.06.2008 " Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë "dhe ligji nr. 7776 dt. 22.12.1993 "Për buxhetin lokal ", ligji nr. 8399 dt.09.09.1998 " Për disa ndryshime në ligjin për buxhetin lokal ",në kompetencat që ka, si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të anëtarëve,

VENDOSI :

Të miratojë prioritetet e investimeve për vitin 2011, të cilat do të financohen nga të ardhurat e Bashkisë nga Grantet Konkurruese të Qeverisë si dhe nga Donatorë të ndryshëm, si vijon :

Në arsim

1. Ndërtim shkolle e re e mesme me fondin prej	100.000.000 lek
2. Shtesë shkolla "Mësonjtore" me fondin prej	35.000.000 lek
3. Shtesë shkolla "Sotir Gurra" me fondin prej	70.000.000 lek
4. Rikonstruksion i shkollës "Sotir Gurra" me fondin prej	40.000.000 lek
5. Rikonstruksion i shkollës "S.Themeli" me fondin prej	20.000.000 lek
6. Rikonstruksion i çatisë së shkollës "N. Veqilharxhi"me fondin prej	10.000.000 lek
7. Rikonstruksion i taracës së shkollës "Demokracia"me fondin prej	1.200.000 lek
8. Rikonstruksion i Kopshteve 5,10,12,15 me fondin prej	18.000.000 lek
9. Përfundimi i palestrës së shkollës "Sevasti Qiriazhi" me fondin prej	6.000.000 lek
10. Paisje për shkolla e kopshte, me fondin prej	40.000.000 lek
11. Studime projektme për arsimin me fondin prej	15.000.000 lek
12. Rikonstruksioni i godinës së shkollës "Raqi Qirinxhi" me fondin prej	45.000.000 lek
13. Rikonstruksioni i godinës së shkollës "Themistokli Gërmenji" me fondin prej	24.500.000 lek
14. Rikonstruksion i godinës së shkollës "Nuçi Naçi" me fondin prej	6.500.000 lek
15. Ndërtim palestre në shkollën Teknike Ekonomike, me fondin prej	25.000.000 lek
16. Ndërtim palestre në shkollën tek ish konvikti i shk. "D. Progri", me fondin prej	25.000.000 lek

17. Ndërtim palestre në shkollën “Azdreni”, me fondin prej	14.000.000 lek
Në infrastrukturë	
18. Ndërtim zona këmbësore, sheshi Teatrit , shetitore Shen Gjergji, sheshi para Katedrales me fondin prej	290.000.000 lek
19. Rikonstruksion fasada përgjatë Bulevard “Republika”, me fondin prej	23.000.000 lek
20. Rikonstruksion i trotuareve tek Kinema Majestik	3.000.000 lek
21. Sistemim rrugë e lulishte tek blloku i banimit lagja 4, me fondin prej	40.000.000 lek
22. Sistemim rrugë e lulishte tek blloku i banimit lagja 5, me fondin prej	30.000.000 lek
23. Sistemim rrugë e lulishte tek blloku i banimit lagja 10 (Lagja e Re Sporti), me fondin prej	40.000.000 lek
24. Sistemim, asfaltim prapa pallateve të lagjes 12, me fondin prej	5.000.000 lek
25. Sistemim rrugë e lulishte tek blloku i banimit lagja 14 me fondin prej	45.000.000 lek
26. Sistemim rrugë e lulishte tek blloku i banimit lagja 16/ me fondin prej	20.000.000 lek
27. Sistemim rrugë e lulishte tek blloku i banimit lagja 16/1 me fondin prej	15.000.000 lek
28. Sistemim rrugë e lulishte tek blloku i banimit lagja 17 me fondin prej	15.000.000 lek
29. Sistemim rruga “6 Dëshmorët”, lagja 6, me fondin prej	3.000.000 lek
30. Rikonstruksion i rrugës “ Nënë Tereza” e “Avni Rustemi” me fondin prej	20.000.000 lek
31. Rikonstruksion i rrugës që të çon tek Varrezat e dëshmorëve, me fondin prej	20.000.000 lek
32. Ndërtim i lulishtes tek Shetroja , me fondin prej	60.000.000 lek
33. Ndërtim rrugë e re tek zjarfiksjja, me fondin prej	25.000.000 lek
Në Shëndetsi	
34. Blerje Qendër Shëndetësore lagja 9 me fondin prej	7.000.000 lek
35. Blerje Qendër Shëndetësore lagja 3 me fondin prej	7.000.000 lek
36. Blerje Qendër Shëndetësore lagja 17 me fondin prej	5.000.000 lek
37. Rikonstruksion dhe përshtatje për shtesë në çerdhen e qytetit	2.500.000 lek
Në institucionet nëvarësi të Bashkisë	
38. Rikonstruksion në zyrat e ish gjykatës fondin prej	1.800.000 lek.
39. Punime rikonstruksioni në bibliotekat e qytetit me fondin prej	1.600.000 lek
40. Rikonstruksion i pistës së stadiumut, me fondin prej	40.000.000 lek
41. Ndërtim ambjente ndihmëse të aneksit të stadiumit dhe rrethim, me fondin prej	4.000.000 lek
42. Punime në shtëpinë Arumune, me fondin prej	3.000.000 lek
43. Rikonstruksion i fushës së lojrave me dorë, me fondin prej	12.000.000 lek
44. Rikonstruksion zyra e Kryetarit të Bashkisë me fondin prej	800.000 lek.
45. Rikonstruksion i zyrës së informacionit me fondin prej	1.000.000 lek
46. Rikonstruksion i zyrave të UMB me vlerën prej	23.000.000 lek
47. Rikonstruksion i kabanonit të UMB me vlerën prej	25.000.000 lek
48. Rikonstruksion i ambjenteve të tregut të qytetit, me fondin prej	10.000.000 lek
49. Rikonstruksion i pazarit (zona muze), me fondin prej	200.000.000 lek
50. Rikonstruksion i godinës së Rajonit administrativ Nr. 2 e garazhit, me fondin prej	1.000.000 lek
51. Rikonstruksion i godinës së Rajonit administrativ Nr. 1 me fondin prej	1.000.000 lek
52. Rikonstruksion dhe përshtatje për teatër kukullash me fondin prej	10.200.000 lek
53. Rikonstruksion i fasadave të pallateve, përgjatë Bulevard “Partizani” me fondin	6.000.000 lek
54. Shpronësim për Varrezat Publike me fondin prej	48.000.000 lek
55. Rikonstruksion i sallës së koncerteve dhe nyjeve sanitare në Qendra Kulturore	

“Kangjush Mio” me fondin prej	5.200.000 lek
56. Rikonstruksion i godinës së Qendrës së Reabilitimit (Azili), me fondin prej	2.000.000 lek
57. Rikonstruksione në territore publike dhe institucione në lidhje me përshtatshmërinë për personat me aftësi të kufizuar me fondin prej	1.000.000 lek

Për efikasitetin e energjisë

58. Vendosje panelesh djellore në kopështe dhe institucione.	33.000.000 lek
59. Zëvendësimi me llampa ekonomike të ndriçimit të brendshëm të objekteve në varësi të bashkisë	1.100.000 lek
60. Zëvendësimi me llampa ekonomike të ndriçimit rrugor	4.200.000 lek

Të tjera

61. Rikonstruksion i fasadave dhe rrethimeve me mur guri dhe kangjella hekuri dekorative të banesave, përgjatë rrugës “Kongresi i Përmetit”, me fondin prej	35.000.000 lek
62. Studime projektive me fondin prej	10.000.000 lek.
63. Vendosje orash në qytet, me fondin prej	3.000.000 lek
64. Ndërtim ambjente dyqane, për banesat me qëllim Social lagja 10, projekti CEB, me fondin prej	20.000.000 lek
65. Punime për sistemimin e bllokut të banesave me qëllim social, lagja 10, projekti CEB, me fondin prej	10.000.000 lek

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Projekteve në Infrastrukturë, Drejtoria e Financës.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

GJERGJI PENDAVINJI

